

URDHËR
Nr. 390, datë 18.9.2018

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS TIP NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL DHE ORGANIZATAVE TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT PËR
USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË ZONAT BASHKËMENAXHUESE TË
PESHKIMIT**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, si dhe në pikën 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kontratës tip që do të lidhet ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP), për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në zonat bashkëmenaxhuese të peshkimit, sipas modelit bashkëlidhur.
2. Në lidhjen, rast pas rasti të kontratave me Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit, kontrata që do të nënshkruhet, mund të përmbajë edhe kushte të tjera shtesë, që reflektojnë specifikat e zonave të shpallura si zona bashkëmenaxhuese peshkimi.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA) dhe OMP-të.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Niko Peleshi

KONTRATË TIP

PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE ORGANIZATËS SË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT

Kjo marrëveshje përbën kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit, regjistruar si OJF, me vendimin nr.____, datë _____._____, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor _____, njohur me vendimin e ministrit përgjegjës të fushës nr. _____, datë _____._____. _____.

Marrëveshja është hartuar në përputhje me dispozitat e:

- Ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar;
- Ligji nr. 103/2016, datë 20.10.2016, “Për akuakulturën”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.7.2013, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. _____, datë _____._____, “Për shpalljen e _____ (vendoset kategoria ujore) _____ (vendoset emri) si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 10.4.2013, “Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për strategjinë kombëtare të peshkimit”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 10.4.2013, “Për ngritjen e sistemit të inspektimit për parandalimin, shkurajimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të parregulluar dhe të paraportuar (PPP) dhe krijimin e skemës së certifikimit të zënieve në peshkim”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 407, datë 8.5.2013, “Për përcaktimin e një regjimi kontrolli për të garantuar respektimin e rregullave të politikave menaxhuese në peshkim”, të ndryshuar;

- Rregulloja nr. 1, datë 7.3.2014, “Për zbatimin e ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, ‘Për peshkimin’”.

Neni 1

Palët

Palët në këtë Marrëveshje janë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, këtu e në vijim “Ministria” dhe Organizata e Menaxhimit të Peshkimit _____, person juridik shqiptar, me numër unik të identifikimit të subjektit NIPT: _____, me adresë: _____, përfaqësuar nga kryetari z./znj. _____, shtetas/e shqiptar/e, me numër personal _____, këtu e në vijim “OMP”.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia e së drejtës për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit dhe menaxhimit të rezervës peshkore në zonën bashkëmenaxhuese të peshkimit në _____ (vendoset kategoria ujore) _____ (vendoset emri) nga ana e OMP-së “_____”, në bashkëpunim me MBZHR-në, duke përcaktuar kushtet për kryerjen e aktivitetit, të drejtat dhe detyrimet e Palëve.

Aktivitetet e peshkimit do të rregullohen në bazë të legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën, të sipërcituara, si dhe të Planit të Bashkëmenaxhimit të Peshkimit, në _____ (vendoset kategoria ujore) _____ (vendoset emri).

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë lidhet për një afat kohor prej 10 (dhjetë) vjetësh, afat i cili fillon nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4
E drejta e peshkimit

OMP-ja ka të drejtë:

4.1 Të zhvillojë aktivitete të peshkimit artizanal, nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe veglave/mjeteve të peshkimit, në përputhje me legjislacionin e peshkimit.

4.2 Të ushtrojë peshkim artizanal vetëm në ato objekte ujore, të cilat janë shpallur zona të bashkëmenaxhimit të _____ (*vendoset kategoria ujore*) _____ (*vendoset emri*).

4.3 Të hartojë Planin e Bashkëmenaxhimit të Peshkimit për _____ (*vendoset kategoria ujore*) _____ (*vendoset emri*) në bashkëpunim me Ministrinë, për një periudhë jo më të gjatë se 10 vjet.

4.4 Të garantojë që në zonën bashkëmenaxhuese nuk zhvillojnë aktivitetet peshkimi persona që nuk janë anëtarë të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit.

4.5 Të marrë përgjegjësitë në bashkëpunim me Ministrinë dhe strukturën shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin në peshkim, për mbrojtjen e resurseve peshkore të liqenit dhe zbatimin e ligjit dhe të rregulloreve të peshkimit, duke ngritur një strukturë përgjegjëse për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe shfrytëzimin racional të burimeve peshkore në _____ (*vendoset kategoria ujore*) _____ (*vendoset emri*).

Neni 5
Detyrimet e Palëve Kontraktuese

1. OMP-ja depoziton pranë drejtorisë që mbulon peshkimin, listën e peshkatarëve, që janë anëtarë të rregullt të kësaj Organizate, sipas numrit të subjekteve të peshkimit të miratuara së fundmi, që është _____ subjekte, me zonimin përkatës dhe/apo sipas formave të peshkimit (artizanal me mrezha, njica, grepa, me tratë për gjuhçën etj.).

2. Aktiviteti i tyre i peshkimit do të jetë në funksion të planit të bashkëmenaxhimit, i cili do të hartohet nga OMP-ja në bashkëpunim me drejtorinë që mbulon peshkimin dhe do të miratohet nga ministri.

3. OMP-ja duhet të shmangë dhe të mënjanojë mbishfrytëzimin e rezervës peshkore, të zhvillojë vetëm peshkim artizanal dhe joindustrial, të mbrojë e të konservojë biodiversitetin, si dhe ihtiofaunën e _____ (*vendoset kategoria ujore*) _____ (*vendoset emri*), nëpërmjet:

- Ndalimit të peshkimit ilegal;
- Ndalimit të peshkimit me çfarëdolloj mjeti dhe metode gjuetie, mbajtjen në bord, tranzitimin në barkë, zbarkimin e qëllimtë të _____ prej _____ deri më _____ (*këtu vendosen llojet e specieve që nuk mund të gjuben në periudha të caktuara në përputhje me rregulloren për peshkimin*);
- Mbrojtjes së zonave të shtimit të peshqve;
- Pastrimit të të gjitha kurtheve artizanale (koceve) të instaluar në breg të kategorive ujore për kapjen e krapit, si dhe parandalimin e instalimit sërish të tyre nga komuniteti përreth;
- Të mos lejojë peshkimin me mjete tërheqëse në formë gabiesh, dragash;
- Ndalimit të peshkimi tregtar industrial;
- *këtu vendosen llojet e mjeteve/pajisjeve që nuk mund të përdoren për gjueti sipas specieve në përputhje me rregulloren për peshkimin apo dhe mjetet me karakteristikat përkatëse që lejohet të përdoren për peshkim*);

4. OMP-ja pajis anëtarët e saj me lejen përkatëse për ushtrimin e së drejtës së veprimtarisë së peshkimit, sipas modelit të lejes tip të miratuar nga ministri.

5. Në lëshimin e dokumentacionit të mësipërm, Organizata sigurohet që çdo anëtar të jetë i pajisur me dokumentet përkatëse sipas ligjit (certifikatë regjistrimi në QKB, certifikatën e mjetit lundrues dhe mandatpagesën e taksës vjetore për zhvillimin e aktivitetit);

6. Në përzgjedhjen e anëtarëve (në respekt të statutit të saj), OMP-ja bazohet në kritere të barabarta, si dhe në bazë të eksperiencës që kanë subjektet fizike/juridike në këtë sektor. Në vitet në vazhdim ajo bazohet edhe në eksperiencën e subjektit në zbatimin e ligjshmërisë në peshkim gjatë vitit paraardhës, si dhe në shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit, statuti, deklarimi i të dhënave statistikore, etj.;

7. Kujdeset që varkat e peshkimit të jenë në një ngjyrë dhe të kenë vend-bazim të përcaktuar dhe të miratuar nga ana e saj;

8. Ministria dhe OMP-ja bashkëpunojnë në vazhdimësi për të siguruar zbatimin e legjislacionit të peshkimit. Në rast se, struktura shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin në peshkim konstaton shkelje të ligjit nga anëtarët e OMP-së, krahas ndjekjes së procedurës së përcaktuar në ligj, një kopje të procesverbalit ia dërgon OMP-së, e cila bashkëpunon në zbatimin e vendimeve të marra nga struktura shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin ndaj anëtarëve të saj, për shkeljet në peshkim të konstatuara dhe të proceduara;

9. Ministria, nëpërmjet strukturave të saj, merr masa brenda kompetencave ligjore, për të siguruar respektimin e së drejtës së ushtrimit të aktivitetit, që i është dhënë subjektit të mësipërm, bazuar në këtë kontratë, të parashikuar në nenet 55, 56, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "*Për peshkimin*", të ndryshuar;

10. Ministria dhe OMP-ja, brenda një viti nga firmosja e kësaj kontrate, duhet të hartojnë Planin e bashkëmenaxhimit të peshkimit të zonës së dhënë për shfrytëzim dhe menaxhim sipas përcaktimeve të nenit 55, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, "*Për peshkimin*", të ndryshuar;

11. Ministria, nëpërmjet drejtorisë që mbulon peshkimin, gëzon të drejtën ligjore të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e OMP-së, veçanërisht për:

- Raportim të rregullt, në mënyrë periodike dhe korrekte, të strukturat përkatëse në drejtorinë që mbulon peshkimin, brenda 10-ditëshit të parë të çdo muaji, të të dhënave mbi sasinë e peshkimi të çdo lloji peshku për muajin paraardhës, si dhe brenda datës 15 janar të çdo viti për të dhënat e përgjithshme për vitin paraardhës.

- Respektim të legjislacionit, veçanërisht, të numrit të peshkatarëve sipas aktivitetit të miratuar, në zonat e përcaktuara/ndaluara, specieve të lejuara/ndaluara, të veglave dhe pajisjeve të peshkimit të lejuara/ndaluara, afatet kohore ligjore të peshkimit, periudhave të ndalimit të peshkimit, dimensionet e veglave të peshkimit dhe peshkut të zënë, të procedurave të trajtimit të produktit deri në treg.

12. Shkeljet për rastet e lartpërmendura, duhet të konstatohen në një akt të veçantë, të mbajtur midis palëve ose përfaqësuesve të tyre, sipas dispozitave ligjore përkatëse, i cili nënshkruhet në prani të tyre;

13. Për çdo shkelje të konstatuar, në zbatim të pikave të mësipërme të kontratës, zbatohen dispozitat ligjore në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, me masën e gjobës së parashikuar në ligj deri në prishjen e kontratës;

14. OMP-ja nuk mund të transferojë të drejtën e siguruar nga kjo kontratë për përdorimin e objektit të tretët;

15. OMP-ja nuk ka të drejtë të lidhë nënkontrakte me subjekte të tjera;

16. OMP-ja ka për detyrë të lejojë dhe të shoqërojë përfaqësuesit e strukturës shtetërore përgjegjëse për inspektimin/kontrollin dhe monitoruesit e peshkimit në ministri, që të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratë, si dhe të kryejë detyrat funksionale në bazë të legjislacionit në fuqi;

17. OMP-ja detyrohet të zbatojë çdo dispozitë të re ligjore/nënligjore ose ndryshim të dispozitave ligjore ekzistuese në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, si dhe të statusit mjedisor të zonës;

18. Përdorimi i infrastrukturave të lidhura me veprimtarinë e peshkimit të kësaj organizate, realizohet sipas kritereve dhe kushteve që vijnë:

- të mos ndryshohet destinacioni dhe qëllimi;

- të garantohet përdorimi i infrastrukturës së peshkimit nga ana e shtetit në rastet e masave të jashtëzakonshme;
- të ruhet dhe të garantohet interesi publik;
- të ruhet dhe të rritet vlera ekonomike.

Neni 6

Modifikimi i kontratës

Modifikime në këtë kontratë nuk lejohen. Në raste të veçanta çdo modifikim lejohet vetëm pas miratimit me shkrim nga të dyja palët dhe përpilimit të aneks-kontratës përkatëse shtesë.

Kjo kontratë mund të rishikohet nga ana e ministrisë dhe OMP-së, në rast se zona e bashkëmenaxhimit e miratuar për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit do të jetë objekt i zbatimit të projekteve apo i një statusi më të lartë mbrojtjeje mjedisore apo menaxhuese të miratuara nga shteti shqiptar.

Neni 7

Përfundimi i kontratës

1. Kjo kontratë përfundon në momentin e përfundimit të afatit të saj të përcaktuar në kontratë.
2. Kjo kontratë përfundon para afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj, kur OMP-ja:
 - 2.1 Pushon së ekzistuari;
 - 2.2 Nga veprimtaria e anëtarëve të saj cenohet rëndë mjedisi dhe provohet se OMP-ja nuk ka marrë masa ndaj anëtarëve të saj, sipas detyrimeve të përcaktuara në statut;
 - 2.3 Brenda një viti nga çasti i nënshkrimit të kësaj kontrate, nuk harton dhe fillon zbatimin e Planit të Bashkëmenaxhimit të Peshkimit në _____ (*vendoset kategoria ujore*) _____ (*vendoset emri*);
 - 2.4 Nuk zbaton parashikimet ligjore dhe/ose statutores dhe bëhet shkak për moszbatimin e detyrimeve të parashikuara në Planin e Bashkëmenaxhimit të Peshkimit në _____ (*vendoset kategoria ujore*) _____ (*vendoset emri*);
 - 2.5 Në qoftë se pas nënshkrimit të kontratës, vërtetohet me fakte, se e drejta e zhvillimit të aktivitetit është dhënë në bazën e të dhënave jo të sakta dhe fakteve të pavërteta;
 - 2.6 Nuk plotëson detyrimin për plotësimin dhe komunikimin e deklarimeve statistikore deri në datën 10 të çdo muaji për muajin paraardhës;
 - 2.7 Nuk përmbush detyrimet që ndërmerr, si riparimi i infrastrukturave ekzistuese, ndërtimi i infrastrukturave të reja, si dhe pagesat vjetore;
 - 2.8 Nuk njihet më, në vijim të tërheqjes së njohjes nga ministri, në përputhje me nenin 62, pika 3, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga ose në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër, duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Personat e autorizuar duhet të bëjnë përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.
4. Procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përcaktohen dhe mbikëqyren nga ministria.
5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, palët do t'i drejtohen gjykatës administrative kompetente.

Neni 9
Të ndryshme

1. Kjo kontratë rregullohet dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Çdo kusht i kësaj marrëveshjeje që bie në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi, konsiderohet i pavlefshëm. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet parashikimeve të marrëveshjes dhe parashikimeve ligjore në fuqi, do të konsiderohet se mbizotërojnë parashikimet e ligjit dhe/ose akteve të tjera ligjore, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në këtë kontratë.

3. Kjo kontratë nënshkruhet në 4 kopje origjinale, nga të cilat tri depozitohen në ministri dhe një tek OMP-ja.

4. Kontrata hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Sot, në Tiranë, më _____._____.

PALËT KONTRAKTUESE:

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Ministri	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit “_____” Kryetari i OMP-së “_____”
--	---